



ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 1 nga 45

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA		AGJENCIA E SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR AGENCIJA ZA VAZDUŠNO NAVIGACIJSKE USLUGE AIR NAVIGATION SERVICES AGENCY	
ZYRA E ARKIVES KANÇELARIA JPHIVA ARCHIVES OFFICE			
Nr. fq. Br. str. Pg. no.	45	Data Datum Date	02.12.24
Nr. prot. Br. pist. Prot. no.	0671	N-T LIPJAN, RKS	

PLANI I BIZNESIT PËR PERIUDHËN 2025 - 2029

	Përgatiti	Kontrolloi	Aprovoi
Emri Mbiemri	SHERIF GJOSALCI	PETRI MURTEZAJ	SAMIR BLACAKU
Nënshkrimi			
Data	02.12.2024	02.12.2024	02.12.2024



ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 2 nga 45

LISTA E SHPËRNDARJES

Kopja	Vendndodhja	Forma	Copë
2	Sistemi për Menaxhimin e Dokumentacionit (SMD) i ASHNA-s	Elektronike	1
3	Arkivi i ASHNA	E shtypur	1
4	AACK	Elektronike	1



ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 3 nga 45

SHKURTESAT

Shkurtesat	Kuptimi
AACK	Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës
ASHNA	Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
DATS	Departamenti për Shërbimet e Trafikut Ajror
DMET	Departamenti Meteorologjik
DAIS	Departamenti për Shërbime të Informatave Aeronautike
DBNJ	Departamenti i Burimeve Njerëzore
DCSS	Departamenti për Cilësi, Siguri dhe Sigurim
DFIN	Departamenti i Financave
DPRK	Departamenti i Prokurimit
DTEK	Departamenti Teknik
DZHT	Departamenti për Zhvillim dhe Trajnim
KBS	Komiteti për Buxhet dhe Siguri
ZYDR	Zyra e Drejtorit
LKIA	LIMAK – Koncesionari për Ofrimin e Shërbimeve të Terminalit në Aeroportin e Prishtinës
ICAO	Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil
Eurocontrol	Organizata Evropiane për Menaxhimin e Trafikut Ajror
KFOR	Forca e Kosovës nën patronatin e Kombeve të Bashkuara
FL	Niveli i Fluturimit
NATO	Organizata Ushtarake TransAtlantike
ISO	Standard Evropian
SMS	Sistemi për menaxhimin e Sigurisë
ATM	Menaxhimi i Trafikut Ajror
AFTN	Rrjeti Ndërkombëtarë Fiks i Telekomunikimit
BKPR	Kodi sipas ICAO për Aeroportin e Prishtinës
ATFM	Air Traffic Flow Management
KPI	Indikatorët kyq të performancës
IFR	Rregullat instrumentale të Fluturimit
VFR	Rregullat e Fluturimit me shikueshmëri
TNC	Tarifa Terminale e Navigacionit
TSU	Njësia e Shërbimeve Terminale
SLA	Marrëveshje në Nivele Shërbimi Mirëmbajtjeje
VCSS	Sistem Komunikimi
AWOS	Sistem Automatik për Vrojtme Meteorologjike
VOLMET	Informatë Meteorologjike për Fluturaket në Mbifluturim
ARKEP	Agjencia e Akredituar Kosovare për Frekuenca
MNAV	Agjencia e Navigacionit Ajror të Maqedonisë së Veriut
Albcontrol	Agjencia e Navigacionit Ajror të Shqipërisë
ILS	Sistem për Ulje Instrumentale
MSSR	Sistem Radarik Sekondar
DVOR/DME	Sistem navigimi për Ulje/ngritje të fluturakeve
TI	Teknologji Informative
ZTLK	Zyra për Tension të Lartë dhe Klima
AMHS	Sistem Automatik për Bartjen e Mesazheve Aeronautike
THD	Të Hyra të Dedikuara
GQ	Grante Qeveritare



ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 4 nga 45

PËRMBAJTJA

LISTA E SHPËRNDARJES	2
SHKURTESAT	3
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
2. OBJEKTIVAT KRYESORE	6
3. SIGURIA	9
4. BURIMET NJERËZORE	10
5. STRATEGJIA	12
6. FUSHAT KYÇE STRATEGJIKE	13
7. TREGUESIT E PERFORMANSËS	19
8. PLANI FINANCIAR	24
9. ANALIZA E PLANIT FINANCIAR.....	28
10. RREZIQET DHE NDIKIMI NË PLANIN E BIZNESIT	43
11. SKEMA ORGANIZATIVE E ASHNA.....	44
12. AZHURNIMI I PLANIT AFATGJATË TË BIZNESIT	45



ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 5 nga 45

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror e Republikës së Kosovës (ASHNA) është agjenci shtetërore, e themeluar me Ligjin Nr. 04/L-250 për "Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror" (Ligji për ASHNA), me përgjegjësi për ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës. Për shkak të kufizimeve që burojnë nga "statusi politik", fushëveprimi shtrihet nga niveli tokë (Ground GND) deri në lartësinë 6,250 m (Flight Level FL 205).

ASHNA veprimtarinë e saj e përkufizon në shtyllat kryesore si në vijim:

- ❖ Shërbimet e Kontrollit të Trafikut Ajror
- ❖ Shërbimet Informative Aeronautike
- ❖ Shërbimet Meteorologjike
- ❖ Shërbimet e Komunikimit, Navigimit dhe Vëzhgimit (Survejimit)

Aktivitetet tona, nga aspekti i sigurisë dhe ekonomik rregullohen nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës përmes ligjeve dhe akteve nënligjore vendore, si dhe rregulloreve ndërkombëtare të aviacionit civil, kryesisht të Komisionit European. ASHNA, sipas ligjit, njeh autoritetin e KFOR-it në çështjet e hapësirës ajrore dhe ruan bashkëpunim të vazhdueshëm në çështjet strategjike dhe operative.

Sipas Ligji Nr. 04/L-250 për "Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror", ASHNA i raporton Qeverisë së Republikës së Kosovës. Veprimtaria jonë organizohet dhe zhvillohet në Vrellë, Lipjan, përkatësisht në afërsi të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari".

Aktualisht ASHNA ka 180 nëpunës me pozita dhe funksione të miratuara, kryesisht të organizuara në dy sektorë, operativ dhe administrativ.

Gjatë vitit 2023, ASHNA ka përmbyllur dhe wshtw nw proces tw pwrmbylljes me sukses tw disa projekteve të rëndësishme kapitale, të cilat kanë treguar ndikim të menjëhershëm në ngritjen e sigurisë dhe cilësisë, si për shërbimet tona, ashtu edhe për shfrytëzuesit (kompanitë ajrore, KFOR-in)

Misioni

- Ofrimi i sigurtë, efektiv dhe cilësor i shërbimeve të navigacionit ajror
- Normalizimi i plotë i hapësirës ajrore të Republikës së Kosovës

Vizioni

ASHNA do të jetë konkurrese në ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror me efikasitetin më të lartë të kostos në rajon.

Kjo do të arrihet përmes zhvillimit të vazhdueshëm të burimeve njerëzore, moderizimit të infrastrukturës, ngritjes dhe përmirësimit të bashkëpunimit me klientët tanë dhe palët tjera të interesit.



ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 6 nga 45

2. OBJEKTIVAT KRYESORE

Në këtë periudhë pesëvjeçare (2025 - 2029) që mbulohet nga ky Plan Biznesi, përveç objektivit primar, sigurisë së operimeve, ASHNA synon të arrijë modernizimin përmes trendeve teknologjike të industrisë dhe normalizimin e plotë të hapësirës ajrore si asaj të ulët poashtu edhe hapësirës së lartë ajrore, të cilat do kenë ndikim të theksuar në përmbushjen e misionit dhe vizionit tonë si ofrues i shërbimeve të navigacionit ajror dhe njëkohësisht do mbështesnin politikat shtetërore për shtrirjen e autoritetit dhe forcimin e sovranitetit në hapësirën ajrore të Kosovës.

Normalizimi i Hapësirës Ajrore

Hapësira e ulët ajrore/hapja e rrugëve ajrore me vendet fqinje

Normalizimi i hapësirës së ulët ajrore të Kosovës ka filluar që nga viti 2014 dhe nënkupton hapjen e rrugëve ajrore dhe pikave të kordinimit të trafikut ajror për trafik civil midis Republikës së Kosovës dhe të gjitha vendeve fqinje (Shqipërisë, Malit të Zi dhe Serbisë), që do të shërbenin për të gjithë avionët që fluturojnë në ANP "Adem Jashari" dhe tranzit për aeroporte tjera në rajon. Rrugët e reja ajrore do ta shkurtonin kohën e fluturimit prej 15-30 minuta, zvogëlonin emetimin e gazrave të dëmshme dhe do të ulnin koston e operimit për kompanitë ajrore.

Aktualisht, hapësira e ulët ajrore është e normalizuar me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë. Në procesin e normalizimit të udhëhequr nga NATO, përmes forumit BANM, synohet të hapen rrugët ajrore edhe me Malin e Zi. ASHNA ka realizuar të gjitha përgatitjet e nevojshme, si: procedurat instrumentale konvencionale dhe ato të bazuara në performancë, kapacitetet njerëzore si dhe ka adresuar te autoritetet malazeze draft LoA për koordinim trafiku mes Prishtina APP dhe Podgorica APP. Gjatë vitit 2025 pritet përgjigja nga pala malazeze dhe angazhimet e të gjitha niveleve vendore dhe ndërkombëtare në këtë çështje.

Hapësira e lartë ajrore /menaxhimi-ofrimi i shërbimeve të navigacionit ajror

Aktualisht, shërbimet e navigacionit ajror në hapësirën e lartë ajrore të Kosovës nga FL 205 deri në FL 660 ofrohen nga Hungarocontrol. Në bashkëpunim me Qeverinë e Republikës së Kosovës, NATO-n (KFOR) dhe të gjitha palët tjera të interesit, ASHNA, në kuadër të autorizimeve dhe kapaciteteve të saj, ka bërë dhe vazhdon me përgatitjet e nevojshme për ofrim të shërbimeve të navigacionit ajror edhe në hapësirën e lartë ajrore. Ky projektion për ASHNA-në nënkupton mesatarisht 147.000 mbi-fluturime, që mund të krijojnë të hyra vjetore rreth 6-8 milion euro.

Përveç kërkesave dhe aktiviteteve politiko - ligjore, përgatitjet për menaxhimin e hapësirës së lartë ajrore kërkojnë edhe një varg veprime tjera teknike/ investime siç janë;

- Instalimi i një sistemi të ri ATM (në proces dhe përfundon në vitin 2026); Sistemi i Ri ATM do përdoret për menaxhim të trafikut ajror për të gjitha nivelet e fluturimit në hapësirën ajrore të Kosovës.
- Përgaditja e kapaciteteve njerëzore, përkatësisht rekrutimi dhe shkollimi i 24 Kontrollorëve të Trafikut Ajror në vitin 2025;
- Trajnimi i kontrollorëve për "Area Control" (ACC).



ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 7 nga 45

Trajnimi i kontrollorëve për ACS është pjesë e projektit ATM.Ky trajnim ka filluar në vitin 2024, i organizuar në grupe të veçanta dhe pritet të përfundoj gjatë vitit 2025.

Pas përfundimit të trajnimit bazë për ACS, kërkohet trajnimi në vend të punës (OJT), i cili do duhej të zhvillohej në pozitat operative prej ku aktualisht menaxhohet hapësira e lartë ajrore e Kosovës, përkatësisht për fluturimet që mbikalojnë Kosovën.

Duke pasur parasysh që vendi ku potencialisht do duhej të zhvillohej OJT e Kontrollorëve tanë për ACC është në Budapest Control (Hungarocontrol), në këto aranzhime nevojitet mbështetja diplomatike e autoriteteve tona dhe atyre të NATO-s.

CRCO

Për të arritur objektivin e menaxhimit të hapësirës së lartë ajrore, është esenciale edhe integrimi në mekanizma/rrjete të Eurocontrol-it, përkatësisht në Central Route Charging System. Ky sistem përdoret për të grumbulluar të dhënat e nevojshme për fluturimet/fluturaket, të cilat mbikalojnë një hapësirë ajrore përkatëse, me qëllim të faturimit dhe grumbullimit të të hyrave nga mbikalimet ajrore.

CFMU

Central Flow Management Unit- është njësi organizative në Eurocontrol, e cila menaxhon rrjedhën e trafikut ajror në Europë. CFMU përdor sisteme/ aplikacione të veçanta që lidhin të gjitha njësitë e shërbimeve të navigacionit ajror në Europë, por edhe palë tjera të interesit në industri.

Qasja/integrimi në CFMU është i domosdoshmëm për të mundur procesimin e trafikut ajror në hapësirën e lartë ajrore.

MWO

Met Watch Office – është përgjegjësi e themelimit të kësaj njësie me rastin e menaxhimit të hapësirës së lartë ajrore, njësi kjo që do të ofroj shërbimet meteorologjike aeronautike ekskluzivisht në relacion me hapësirën e lartë ajrore.

Modernizimi i sistemeve për menaxhimin e trafikut ajror

Për të arritur këtë objektiv të rëndësishëm, i cili ndikon drejtëpërdrejtë në sigurinë dhe zhvillimin e kapaciteteve tona, ne kemi identifikuar nevojën e zhvillimit dhe implementimit të disa sistemeve të reja në periudhën 2024- 2028.

- **Sistemi i ri ATM** - do të përkufizohet si projekti kryesor për këtë periudhë pesëvjeçare dhe planifikohet të realizohet gjatë vitit 2026. Ky sistem/projekt ka ndërlidhje të ngushtë dhe me procesin e normalizimit të hapësirës ajrore.
- **Multilateration (MLAT)** - është sistem i cili mundëson përcjelljen e fluturakeve në hapësirën manovruese në tokë dhe në hapësirën ajrore, në varshmëri nga numri i sensorëve.
- **Radari Primar (PSR)** - është sistem radarik i survejimit që përdor radio sinjalet e reflektuara. Parimi i funksionimit të këtij radari: antena e radarit rrotullohet (zakonisht me 5-12 rpm), lëshon/emeton një impuls të valëve të radios. Me të arritur fluturaken (ose objekt tjetër) vala



ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 8 nga 45

reflektohet dhe një pjesë e energjisë kthehet në antenë. PSR është sensori i vetëm i mbikqyrjes/survejimit i përdorur në aviacionin civil që nuk kërkon ndonjë pajisje në bord për të lokalizuar aeroplanët. Ndryshe nga SSR, ADS-B dhe MLAT, ai mund të zbulojë një aeroplan që mund të ketë dështim të transponderit ose një ndërhyrës të paautorizuar.

Këtë lloj radari, shtetet e përdorin kryesisht për çështje sigurie, respektivisht në kuadër të sistemit të mbrojtjes.

- **AMHS Aeronautical Message Handling System** - është sistem i cili do zëvendësoj sistemin aktual AFTN, si dhe njëkohësisht edhe ngrit cilësinë dhe efikasitetin e procesimit të mesazheve aeronautike.

Ngritja e kapaciteteve njerëzore

Me qëllim të ngritjes së sigurisë së trafikut ajror dhe harmonizimit të kapaciteteve njerëzore të ASHNA-së me Planet Kombëtare Strategjike, me theks të veçantë menaxhimin e hapësirës së lartë ajrore, ASHNA planifikon rekrutimin e 24 Student Kontrollorëve të trafikut ajror dhe shkollimin e 12 prej tyre gjatë vitit 2025.

Për më shumë, rritja e numrit të kontrollorëve të trafikut ajror, zvogëlon ndjeshëm punët shtesë jashtë orarit, si dhe zbut ngarkesën e madhe si pasojë e numrit të kufizuar të personelit.

Energjia e ripërtëritshme

Në funksion të uljes së shpenzimeve të energjisë elektrike dhe njëkohësisht edhe të ruajtjes së ambientit, ASHNA planifikon që brenda këtij pesë vjeçari të kaloj në shfrytëzim të energjisë së ripërtëritshme. Kjo synohet të arrihet përmes zhvillimit dhe implementimit të projektit për vendosjen dhe integrimin e panelëve solar. Ky objektivi përkon edhe me objektivat e Qeverisë së Republikës së Kosovës për Eficiencë të Energjisë dhe Energji të Ripërtëritshme.



ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 9 nga 45

3. SIGURIA

ASHNA do të vazhdojë të përqëndrohet në zbatimin e kërkesave të sistemit për menaxhimin e sigurisë. Për më tepër do të vazhdohet puna në përmirësimin e performansës së sigurisë për të përmbushur kërkesat ligjore si dhe rekomandimet që rezultojnë nga aktivitetet e ndryshme të sigurisë.





ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 10 nga 45

4. BURIMET NJERËZORE

Përmes hartimit dhe implementimit të planeve për zhvillim dhe trajnim të stafit, ASHNA do të ngrisë kapacitetet e nevojshme për të kryer detyrat dhe përgjegjësitë që rezultojnë nga vendet e tyre të punës. Gjithashtu përmes politikave zhvillimore, synon ruajtjen e stafit për të ardhmen.

Në vitin 2025, nuk parashihet të ketë rritje të numrit të personelit nga 192 sa janë aktualisht të aprovuar. ASHNA planifikon që nga pozitat e lira për këtë vit të i rekrutoj edhe 24 Kandidat për Student Kontrollor të Trafikut Ajror, 2 student parashikues meteorologjik aeronautik, 1 Teknik të Mirëmbajtjes si dhe 5 Inxhinier në Departamentin Teknik.

Stafi i ASHNA-së është i përgatitur dhe i kualifikuar sipas standardeve dhe kriterëve të larta ndërkombëtare të aviacionit civil. Investime të vazhdueshme janë të nevojshme për të ruajtur nivelin e tyre të kompetencës si dhe për t'i avancuar njohuritë dhe shkathtësitë e tyre në përdorimin e teknologjive dhe procedurave të reja të punës.

ASHNA, burimet njerëzore i sheh si elementin kyç për të mundësuar zbatimin e vizionit të vet për ruajtjen dhe avancimin e sigurisë, me efikasitetin më të lartë të kostos në rajon. Rrjedhimisht, ASHNA e sheh të nevojshme që në aspektin afat-mesëm të punësoj staf shtesë, në mënyrë që të jetë në gjendje që të përmbushë kërkesat në rritje që pritet të rezultojnë nga ngritja e vazhdueshme e trafikut në hapësirën e ulët ajrore të Republikës së Kosovës si dhe potencialin për marrjen në menaxhim të hapësirës së lartë ajrore të Republikës së Kosovës.

Si rrjedhojë e planit për normalizim të hapësirës ajrore të Republikës së Kosovës, për vitin 2025 është paraparë rekrutimi i 24 Student Kontrollorëve të Trafikut Ajror, 5 Inxhinierë, 1 Teknik të Mirëmbajtjes dhe 2 Student Parashikues Meteorologjik Aeronautik.

Për vitet 2026 – 2029, nuk është planifikuar rritje e numrit të personelit mbi numrin e aprovuar sa ka ASHNA aktualisht, përjashtimisht zëvendësimin e personelit që do të pensionohet me plotësimin e moshës së pleqërisë sipas ligjit.

Rritja e numrit të personelit për vitet 2025-2029 është paraqitur në tabelën në vijim:

Viti	Numri i stafit i planifikuar për rekrutim	Numri total i stafit	Departamentet	Nr i stafit për pozita	Pozitat
2024	/	159	ASHNA	/	Punonjës në total
2025	24	183	Departamenti i Shërbimeve të Trafikut Ajror	24	Student Kontrollor të Trafikut Ajror
2025	5	188	Departamenti Teknik	5	Inxhinier
2025	1	189	Departamenti i Administratës	1	Teknik i Mirëmbajtjes
2025	2	191	Departamenti Meteorologjik	2	Student Parashikues Meteorologjik Aeronautik



ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 11 nga 45

2026	3	191	Zëvendësim i personelit të pensionuar	3	Në Departamente të ndryshme në ASHNA
2027	/	191	/	/	/
2028	2	191	Zëvendësim i personelit të pensionuar	2	Në Departamente të ndryshme në ASHNA
2029	2	191	Zëvendësim i personelit të pensionuar	2	Në Departamente të ndryshme në ASHNA



ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 12 nga 45


5. STRATEGJIA

Është qëllim strategjik i ASHNA që të optimizojë shfrytëzimin e resurseve të veta në dispozicion për të arritur një performansë të lartë të kost-benefitit.

ASHNA synon të zbatojë strategjinë e saj përmes përqëndrimit në tri fusha kyçe:

- Maksimizimin e performansës së sigurisë;
- Krijimin e një strukture organizative me performansë të lartë;
- Arritjen e performansës së lartë operative dhe biznesore përmes përmirësimit të proceseve të punës.

Ndërlidhja e komponentëve të strategjisë së ASHNA





ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 13 nga 45

6. FUSHAT KYÇE STRATEGJIKE

Fushat kyçe të paraqitura në vijim dhe rezultatet e tyre shërbejnë për të dhënë "inpute" me rëndësi në zhvillimin e iniciativave kyçe të ASHNA-së, që janë të synuara në arritjen e kërkesave të përcaktuara. Kjo synohet të arrihet përmes përbushjes së pritjeve të klientëve, përmirësimit të proceseve të punës dhe vazhimit të zhvillimit të stafit dhe infrastrukturës.





ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 14 nga 45

Maksimizimi i performansës së sigurisë

Rritja e besimit të publikut dhe palëve me interes në sigurinë e aviacionit

Ruajtja dhe përmirësimi i vazhdueshëm i sigurisë së operimeve

Azhurnimi i sistemeve teknike duke mos afektuar nivelin e sigurisë

Siguria dhe integriteti i sistemit të navigimit ajror, së bashku me mirëqenien e stafit janë konsideratat kryesore të ASHNA. Performansa e sigurisë së ASHNA-së bazohet në ofrimin e shërbimeve të sigurta dhe efikase si dhe në bashkëpunimin me organizatat rajonale dhe ndërkombëtare, për të zvogëluar rrezikun në nivel të pranueshëm.

Fusha strategjike e maksimizimit të performansës së sigurisë vazhdon të ndërtohet mbi dy qëllime kyçe:

- zvogëlimi i riskut të ndërlidhur me rreziqet kyçe operative dhe të vendit të punës;
- arritja e objektivave të sigurisë.

ASHNA shprehë zotimin e vet ndaj ngritjes së besimit të klientëve dhe palëve me interes, si dhe arritjes së rezultateve pozitive të sigurisë. ASHNA në mënyrë proaktive përmes zbatimit të Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë do të sigurojë ruajtjen apo përmirësimin e sigurisë së operimeve.

ASHNA do të punojë drejt krijimit të një ambienti të shëndoshë dhe sigurtë të punës për stafin e vet, duke theksuar nevojën për rezultate që tregojnë përmirësim të vazhdueshëm të kushteve të punës.

ASHNA do të angazhohet në aktivitete dhe forume bashkëvepruese të sigurisë në nivel vendor, rajonal dhe ndërkombëtar, me qëllim të përmirësimit të ndarjes së informatave të sigurisë dhe mësimave të mësuara.



Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 15 nga 45

Caqet dhe treguesit kyç të performansës së Sigurisë 2025- 2029

Nr	TKP (SPI) për procese	Treguesi i sigurisë	Masat e parapara	Caqet e performansës së sigurisë për vitet 2025 - 2029
1	Incidentet me ndikim në ATM	Numri i incidenteve me ndikim të Menaxhimit të Trafikut Ajror (ATM)	Të vetëdijesohet stafi që në mënyrë proaktive të identifikojë hazardet që mund të shprijnë drejtë cenimit të sigurisë.	Numri i incidenteve me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 9 incidente në vitin 2025.
2	Funksioni i Navigimit	Numri i dështimeve të funksionit të Navigimit me ndikim të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të zvogëlohet	Me implementimin e projektit për zgjatjen e pistës (Kontrata mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe LKIA për "Zgjatjen e pistës, ngritjes së sistemit instrumental të aterimit dhe sistemeve të radiokomunikimeve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës Adem Jashari" nr. Identifikues MI-7-024-5.1.5 dhe nr. të kontratës 023/2017 të datës 09.08.2017), janë instaluar sistemet e reja të navigimit dhe rrjedhimisht numri i dështimeve në këtë fushë do të ulët.	Numri i ndodhjeve të dështimit të funksionit të Navigimit me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 3 dështime në vitin 2025.
3	Funksioni i Survejimit	Numri i dështimeve të funksionit të Survejimit me ndikim të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të zvogëlohet	Është implementuar projekti i radarit të ri në lokacionin e Gjakovës, që rrjedhimisht do të ndikojë në uljen e numrit të ndodhjeve në funksionin e survejimit	Numri i ndodhjeve të dështimit të funksionit të Survejimit me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 3 dështime apo 40 orë në vitin 2025, përfshi këtu edhe ndërprerjet për mirëmbajtje të planifikuara.
4	Funksioni i Komunikimit	Numri i dështimeve të funksionit të Komunikimit me ndikim të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të zvogëlohet	Me implementimin e projektit për zgjatjen e pistës (Kontrata mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe LKIA për "Zgjatjen e pistës, ngritjes së sistemit instrumental të aterimit dhe sistemeve të radiokomunikimeve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës Adem Jashari" nr. Identifikues MI-7-024-5.1.5 dhe nr. të kontratës 023/2017 të datës 09.08.2017), janë instaluar sistemet e reja të komunikimit (radio, VCS, VCR, ATIS) dhe rrjedhimisht numri i dështimeve në këtë sistem do të ulët.	Numri i ndodhjeve të dështimit të funksionit të Komunikimit me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 9 dështime në vitin 2025.



ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 16 nga 45

5	Funksioni ndihmës i informimit	Numri i dështimeve të funksionit Ndihmës të informimit duhet të zvogëlohet	Me implementimin e projektit për zgjatjen e pistës (Kontrata mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe LKIA për "Zgjatjen e pistës, ngritjes së sistemit instrumental të aterritit dhe sistemeve të radiokomunikimeve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës Adem Jashari" nr. Identifikues MI-7-024-5.1.5 dhe nr. të kontratës 023/2017 të datës 09.08.2017), janë instaluar sistemet e reja si AWOS, MESSIR, etj... dhe rrjedhimisht numri i dështimeve në këtë fushë do të ulet.	Numri i ndodhjeve të dështimit të funksionit të funksionit ndihmës të informimit me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 20 dështime në vitin 2025.
6	Funksioni i procesimit të të dhënave	Numri i dështimeve të funksionit procesimit të të dhënave duhet të zvogëlohet	Është në plan prokurimi i sisemit të ri ATM dhe njëkohësisht është duke u punuar në përmirësimin e ATM-it ekzistues. Nëse gjithçka shkon sipas planit, ATM i ri pritet të funksionalizohet brenda 3 viteve. Numri i dështimeve duke pas parasysh gjendjen e sistemit aktual (sistem i vitit 2004) mund të jetë i lartë	Numri i ndodhjeve të dështimit të funksionit të Procesimit të të dhënave me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 30 dështime në vitin 2025.
7	Të tjera	Numri i dështimeve tjera duhet të zvogëlohet	Janë planifikuar trajnime të ndryshme profesionale dhe nga aspekti i sigurisë me të cilat parashihet mes tjerash edhe ndërgjegjësimit i personelit në raport me përgjegjësitë e tyre që ndërlidhen me siguri.	Numri i ndodhjeve të dështimit të funksioneve tjera me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 10 në vitin 2025.

**Me prokurimin dhe instalimin e sistemeve të reja, të cilat kanë përfunduar në vitin 2022, do të ishte e natyrshme që caqet të jenë shumë më të ulëta për vitin 2025 e tutje. Mirëpo, duke pasur parasysh që nevojitet kohë ne adaptimin e faktorit njeri me sistemet e reja, disa prej caqeve i kemi lënë të pandryshuara dhe do ti analizojmë përgjatë vitit 2025. Te funksioni i procesimit të të dhënave kemi paraparë rritje për shkak të vjetërsisë së sistemit. Ndërlidhja e caqeve të performansës së sigurisë me projektet kapitale është shijelluar në kapitullin e 12 - Planifikimi i Investimeve Kapitale për periudhën 2025-2029.*



ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Arovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 17 nga 45

Krijimi i një strukture organizative me performansë të lartë

Stafi është i trajnuar dhe aktivisht i angazhuar
në procese zhvillimore

Krijimi i një kulture të përqëndruar në ofrimin
kualitativ të shërbimeve

Ekipe kompetente

Lidership i fuqishëm dhe efikas

Realizimi i vizionit të ASHNA varet nga stafi, lidershipi dhe kultura organizative e saj. Për të arritur këtë, ASHNA vazhdimisht investon në resurset e veta njerëzore

Investime të vazhdueshme janë të nevojshme për të ruajtur nivelin e kompetencës të stafit si dhe për t'i avancuar shkathhtësitë e tyre. ASHNA në aspektin afatgjatë do të siguroj që numri i stafit në dispozicion të jetë në përputhje me kërkesat operative.

Trajnimet që do të sigurohen nga ASHNA zhvillohen për të përmbushur kërkesat ligjore, apo për zhvillimin e burimeve njerëzore.



ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 18 nga 45

Performansë e lartë operative dhe biznesore përmes përmirësimit të proceseve të punës

Kërkesat ligjore kuptohen qartë dhe zbatohen në mënyrë të mirëfilltë si dhe brenda afateve të nërcaktuara

Ngritja e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve dhe në aspektin biznesor dhe mjedisor

Përmirësimi i vazhdueshëm bazuar në sistemin për menaxhimin e cilësisë

Performansa e ASHNA është e përqendruar në përmirësimin e sigurisë, kapacitetit, efikasitetit të koston dhe ndikimit minimal ndaj mjedisit njëkohësisht duke përbushur nevojat e klientëve dhe duke krijuar vlerë të shtuar për aviacionin civil. Arritja e prioriteteve të përcaktuara në një mënyrë efikase dhe të parashikueshme është esenciale për qëndrueshmërinë financiare të organizatës.

Fusha strategjike e performansës së lartë operative dhe biznesore përmes përmirësimit të proceseve të punës thekson zotimin e organizatës për të përmirësuar efikasitetin e ofrimit të shërbimeve brenda organizatës.

Strategjia operative e ASHNA është e përqendruar në ngritjen e nivelit të automatizimit dhe zbatimin e një sërë sistemesh dhe veglash të reja ndaj sistemit për Menaxhimin e Trafikut Ajror të organizatës. Kjo qasje mundëson përbushjen e kërkesave ligjore dhe në të njëjtën kohë përmirëson efikasitetin dhe sigurinë.

Ne gjithashtu duhet të vazhdojmë të bashkëveprojmë me organizatat tjera të aviacionit civil dhe palë tjera të interes, në mënyrë që të parashikojmë, kuptojmë dhe planifikojmë nevojat e së ardhmes, përmes shërbimeve dhe teknologjive të reja.




ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 19 nga 45

7. TREGUESIT E PERFORMANSËS



Matja e nivelit të kënaqshmërisë së klientëve dhe palëve me interes shërben për përmirësimin e vazhdueshëm të performansës sonë.



ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 20 nga 45

Siguria

Siguria nënkupton zvogëlimin në maksimumin e mundshëm të rreziqeve që mund të rezultojnë në incidente apo aksidente ajrore.

FUSHA E PERFORMANCËS SË SIGURISË

Safety KPI #1: Level of Effectiveness of Safety Management
Shkalla e Efikasitetit të Menaxhimit të Sigurisë

2024	2025	2026	2027	2028	2029
Vlera	Objektivi	Objektivi	Objektivi	Objektivi	Objektivi

Objektivat fillestare të performances (Initial Performance Target Setting)	ASHNA (Objektivat e menaxhmentit për kulturën e sigurisë)	C	C	D	D	D	D
	ASHNA (për të gjitha objektivat tjera të menaxhmentit)	D	D	D	D	D	D
	Përshkrimi i përputhjes së objektivave të ASHNA-së me ato kombëtare	Objektivat e ASHNA-së janë në përputhje me ato kombëtare					
	Arsyeshmëria e detajuar ne rast të mospërputhjes						



ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 21 nga 45

Safety KPI #2: Aplikimi i shkallës së klasifikimit bazuar në metodologjinë (RAT) Risk Analyses

Tool

Ground Score	2024 Vlera	2025 Objektivi	2026 Objektivi	2027 Objektivi	2028 Objektivi	2029 Objektivi
--------------	---------------	-------------------	-------------------	-------------------	-------------------	-------------------

ASHNA (Objektivi i performancës)	SIMs	50%	50%	100%	100%	100%	100%
	RIIs	50%	50%	100%	100%	100%	100%
	ATM- S	50%	50%	100%	100%	100%	100%
Përshkrimi i përputhjes së objektivave të ASHNA- së me ato kombëtare	Në nivel të ASHNA-së, objektivat janë në përputhje me ato kombëtare						
Arsyeshmëria e detajuar në rast të mospërputhjes							

Komentet shtesë

--



ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 22 nga 45

Vonesat

Vonesat do të maten përmes numrit total të fluturimeve të vonuara, minutat totale të vonesës, numrit të vonesave për fluturim ose për fazë të fluturimit, ose kohëzgjatjes mesatare të vonesës për fluturim apo për fluturimin e vonuar, pas vendosjes së një sistemi softuerik gjithëpërfshirës për menaxhimin e trafikut ajror.

Capacity KPI #2: ASHNA ATFM VONESAT AEROPORTUALE DHE TERMINALE NË ARDHJE PËR FLUTURIM

		2024	2025	2026	2027	2028	2029
		Vlera	Objektivi	Objektivi	Objektivi	Objektiv i	Objektiv i
Niveli kombëtar	Objektivi fillestar i performancës	2.5 (min/flu turim)	2.5 (min/flu turim)	2.5 (min/flu turim)	2.5 (min/flu turim)	2.5 (min/flu turim)	2.5 (min/flu turim)

Numri i aeroporteve brenda fushëveprimit të plani të performancës	1
---	---

ASHNA	ASHNA - BKPR (Prishtina International Airport)	2.5 (min/flu turim)	2.5 (min/flu turim)	2.5 (min/flu turim)	2.5 (min/flu turim)	2.5 (min/flu turim)	2.5 (min/flu turim)
	Kontributi i aeroporteve në planin e performancës	Pasi që ka vetëm një aeroport në Kosovë, kontributi i aeroportit në lidhje me vonesat në nivel kombëtarë është 100%					

Komente shtesë	
<p>Kosova nuk është pjesë e Menaxhimit të Rrjetit (Network Manager) Evropian dhe si rrjedhojë nuk bën pjesë në rregulloren e ATFM për alokim të vendit/sllotit. Vonesat e fluturimeve për fluturake në aeroport dhe terminal të ANS ATFM definojnë si në vijim:</p> <p>“Mesatarja e kohës së vonesës së arritjes që i atribuohen shërbimeve për navigim ajror dhe shërbimeve terminale dhe që shkaktohen nga restriktionet gjatë aterimit në aeroportin e destinimit, definojnë si në vijim:</p> <p>(i) treguesi është mesatarja e gjeneruar e vonesës nga ATFM vonesa për çdo fluturim IFR;</p> <p>(ii) treguesi i mbulon të gjitha fluturimet IFR që aterojnë në aeroportin e destinacionit dhe të gjitha shkaqet e vonesës ATFM, me përjashtim të ngjarjeve të jashtëzakonshme;</p> <p>(iii) treguesi llogaritet për tërë vitin kalendarik dhe për çdo vit të periudhës referuese.”</p> <p>Për më shumë, treguesi kalkulohet për rrjedhen e fluturimeve hyrëse që arrijnë në aeroport, përfshin një pjesë të vonesës para nisjes e cila shkaktohet nga kufizimet e aterimit në aeroportin e destinimit.</p>	



ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 23 nga 45

Duke pasur parasysh definimin e shkruar më lartë, pa të dhëna nga Menaxheri i Rrjetit, është e pamundur të llogaritet historiku i saktë i kësaj mesatareje të KPI.

NSA e Kosovës në bashkëpunim me ASHNA- ka shiqur të dhënat e të kaluarës që ruhen lokalisht, të cilat bazohen në alokim vendi/slot në aeroport procedurë lokale, koha e përafërt e arritjes (ETA) (për të gjitha fluturimet hyrëse) dhe koha e saktë e arritjes. *Keni parasysh, alokimi i vendit në aeroport procedurë lokale nuk kryhet në kordinim me Menaxherin e Rrjetit.* Si rrjedhojë, dy lloje vonesash të përsëritura janë kalkuluar për fluturimet ateruese:

- 1) në lidhje me alokimin e vendit në aeroport, si diferenca (në minuta) në mes të ATA dhe slotit, dhe
- 2) referuar ETA, si ndryshim (në minuta) mes kohës ATA dhe ETA.

Sidoçoftë, shkak që slotet nuk janë të kordinuara, lloji i parë i vonesës rezulton në vlera të mëdha vonesë për fluturim. Kjo për shkak që një vonesë e tillë mbulon vonesën e përgjithshme të fluturimit që mund të përfshij: vonesa të shkaktuara në aeroportin e nisjes, vonesat gjatë rrugës si dhe vonesat në aeroport dhe fazën e fundit.

Lloji i dytë i vonesës rezulton me vlera shumë më të vogla, pasi që i mbulon vetem vonesat e shkaktuara mes kohës kur fluturimi kordinohet/transferohet mes njesive të ATC-së.

Në mënyrë që të kemi një vlerë njëjës të vonesës, **ne kemi zgjedhur të përdorim një mesatare të të arsyeshme të dy llojeve të vonesës.** Shkak që, siç e përmendëm slotet nuk kordinohen, është vlerësim i yni që lloji i dytë i vonesës është më i përafërt me vonesën reale të ATFM-së. Si rrjedhojë, kemi caktuar një vlerë prej 20% të vonesës së parë dhe 80% vonesës së dytë. Vlera mesatare e vonesës së 2 viteve paraprake është caktuar si synim për vitet në vijim.

Nga të dhënat eviteve paraprake, që tregojnë vonesa mesatare të shkaktuara gjatë sezonit të dimrit, konstatohet se shumica e vonesave lokale janë shkatohen si pasojë e kushteve meteorologjike, në veçanti mjegullës së dendur në afërsi dhe rreth aeroportit.

Me instalimin e sisteme dhe paisjeve të reja për aterrim ILS (CAT IIIB për pistën 17 dhe CAT I për pistën 35), dy sistemeve të reja AWOS, si dhe me planet për ri-hapje të rrugëve ajrore, pritet që vonesat mesatare do të zvogëlohen në vitet në vijim.

Vëmendje: Kjo pjesë e planit mund të ndryshojë në vitet në vijim, nëse Kosova integrohet në CFMU dhe merr të dhëna nga nga Menaxheri i Rrjetit.



ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Arovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 24 nga 45

8. PLANI FINANCIAR

Plani strategjik financiar ka për qëllim që të përkrahë zbatimin e objektivave operacionale dhe kapitale të ASHNA-së për periudhën 2025 - 2029. Plani parasheh zhvillimin afatgjatë të shërbimeve shtesë për të mundësuar zgjerimin e kapaciteteve teknike dhe njerëzore. Aktivitetet kryesore për periudhën 2025 - 2029 do jenë në funksion të rritjes së sigurisë dhe cilësisë së ofrimit të shërbimeve të navigacionit ajror. Në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë paraqitur shpenzimet operative për periudhën 2025 – 2029, bazuar në nevojat afat-gjate buxhetore të ASHNA-s.

Ofruesit e Shërbimeve të Navigimit Ajror rajonal dhe European si dhe në tërë botën, në shumicën absolute të rasteve pranojnë një përqindje të vogël të hyrave nga hapësira e ulët ajrore, ndërsa shumicën absolute të hyrave i sigurojnë nga menaxhimi i hapësirës së lartë ajrore. Për shkak të pamundësisë së ofrimit të shërbimeve të navigacionit ajror edhe në hapësirën e lartë ajrore, dhe vjeljen e të hyrave nga kjo hapësirë, ASHNA është në pozitë tejet të disfavorshme në aspektin e nivelit të të hyrave krahasuar me ofruesit e shërbimeve të navigimit ajror rajonal dhe evropian.

krahasuar me planet paraprake ka marrë parasysh edhe zhvillimin e shërbimeve shtesë për të mundësuar zgjerimin e kapaciteteve infrastrukturore. Të dhënat në vijim paraqesin pasqyrat financiare të ASHNA për vitin fiskal 2025 - 2029.

ASHNA planifikon të rekrutoj dhe përgatis Kontrollor të Trafikut Ajror, projekt i cili ka një kosto të lartë të shkollimit, andaj edhe në KASH për vitet 2025-2026 janë paraparë shpenzimet për këtë pjesë të shkollimit dhe të trajnimit.

Tarifat e Shfrytëzimit

Tarifat e shfrytëzimit të vlerësuara dhe të mbledhura nga ASHNA do të përfshijnë:

1.1. Tarifat e afrimit të vlerësuara për ofrimin e shërbimit të navigacionit ajror brenda hapësirës ajrore të Kosovës; dhe

1.2. Tarifat e mbi fluturimit të vlerësuara për avionët që janë të autorizuar për ta shfrytëzuar hapësirën ajrore të Kosovës.

ASHNA do të lejohet vetëm për të vlerësuar dhe mbledhur Tarifat e Afrimit dhe Tarifat e mbi fluturimit, kurse rregullimin e tarifave të tilla e bën AAC-ja në përputhje me Ligjin për Aviacionin Civil. ASHNA propozon tarifat e shfrytëzimit për shërbimet e ofruara të navigacionit ajror në mënyrë që tarifat të jenë sa më konkurruese me tarifat e ngjashme të vendosura nga vendet e tjera në Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit dhe të llogaritura mbi bazën e kthimit të arsyeshëm të shpenzimeve duke marrë parasysh tërë burimet e tjera të hyrave. AAC shqyrton dhe miraton tarifën e propozuar nga ASHNA në pajtim me Ligjin për Aviacionin Civil dhe informon Ministrinë për caktimin e tarifave. Tarifat e shfrytëzimit janë obligative për operatorin e avionit. Në qoftë se operatori i avionit është i panjohur, detyrimi për pagesën e tarifës së shfrytëzimit bie mbi pronarin e avionit. Regjimi i tarifave të shfrytëzimit do të përcaktohet me legjislacion për krijimin e një skeme të përbashkët tarifore për shërbimet e navigacionit ajror dhe me ndryshimet/plotësimet e saj. Normat e përcaktuara në këtë mënyrë sigurojnë që të mos ketë diskriminime në mes të shfrytëzuesve të ndryshëm. ASHNA mund t'ia refuzojë ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror një shfrytëzuesi të hapësirës ajrore i cili shkel kushtet e pagesës përveç rasteve emergjente të aterimit.



ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aproximit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 25 nga 45

Vërejtje: Tabelat në vijim janë të paraqitura në gjuhën angleze.

Organisation:	ANSP
Charging zone:	Kosovo Terminal

Year 2025 - 2029

	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029
	A	P	P	F	F	F	F
Staff	3,237,131	3,596,101	3,734,637	3,940,042	4,156,744	4,177,527	4,198,415
	11.20%	11.09%	3.85%	5.50%	5.50%	0.50%	0.5%
Other operating costs	1,124,568	2,489,470	2,582,370	2,112,370	2,112,370	2,147,375	2,153,475
	11.50%	121.37%	3.73%	-18.20%	0.00%	1.66%	0.28%
Depreciation	557,059	595,099	807,902	527,457	527,457	527,457	83,472
	0.00%	6.80%	35.80%	-34.71%	0.00%	0.00%	-84.17%
Cost of capital	122,211	107,581	119,251	63,333	45,671	28,009	17,780
	12.30%	-12.30%	10.80%	-46.89%	-27.89%	-38.67%	-36.52%
Exceptional items							
Total costs	5,040,969	6,788,251	7,244,160	6,643,202	6,842,242	6,880,368	6,453,142
	3.31%	34.66%	11.02%	2.64%	3.00%	0.56%	-6.21%
Detail by services (in euro)							
Air traffic management	2401	2985	3550	3145	3201	3140	3002
	-3.0%	24.3%	18.9%	-11.4%	1.8%	-1.9%	-4.4%
Communication	351	562	628	562	553	590	542
	2.6%	60.1%	11.7%	-10.5%	-1.6%	6.7%	-8.1%
Navigation	954	1012	1302	1201	1289	1316	1215
	46.8%	6.1%	28.7%	-7.8%	7.3%	2.1%	-7.7%
Surveillance	210	460	559	564	561	581	555
	-28.6%	119.0%	21.5%	0.9%	-0.5%	3.6%	-4.5%
Search and rescue	0	0	0	0	0		
Aeronautical information	333	946	812	659	707	722	691
	-45%	184.1%	-14.2%	-18.8%	7.3%	2.1%	-4.3%
Meteorological services	792	823	685	512	531	531	448
	55.3%	3.9%	-16.8%	-25.3%	3.7%	0.0%	-15.6%
Supervision costs	0	0	0	0	0		
Other State costs	0	0	0	0	0		
Total costs	5,041	6,788	7,536	6,643	6,842	6,880	6,453
	22.50%	34.7%	11.0%	-11.8%	3.0%	0.6%	-6.2%



ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 27 nga 45

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

AGJENCIA PËR SHËRBIMET E NAVIGACIONIT AJROR						
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE - BUXHETI 2025-2029 (në Euro)						
Nr	PERSHKRIMI	Buxheti 2025	Buxheti 2026	Buxheti 2027	Buxheti 2028	Buxheti 2029
A	B	C	D	E	E	E
Te Ardhurat						
1	Te hyra nga approach fee	6,994,160	6,393,202	6,592,242	6,630,368	6,203,142
2	Te hyra nga sherbimet e radarit Hungarocontrol	250,000	250,000	250,000	250,000	250,000
3	Granti Qeveritar					
	Gjithsej te Ardhura	7,244,160	6,643,202	6,842,242	6,880,368	6,453,142
Shpenzimet						
1	Pagat dhe medijtjet	3,734,637	3,940,042	4,156,744	4,177,527	4,198,415
2	Shpenzimet e udhetimit	350,000	280,000	280,000	275,000	280,000
3	Sherbimet per telekomunikacion	58,000	58,000	58,000	56,130	57,130
4	Shpenzimet per sherbimet	1,180,476	752,476	812,476	979,845	1,007,845
5	Mobile dhe paisje me vlere <1000 Euro	45,000	65,000	5,000	13,000	13,000
6	Blerje tjera te mallrave dhe sherbimeve	61,000	39,224	39,224	35,000	37,000
7	Derivatet dhe lendet djegese	29,000	32,000	32,000	37,500	44,000
8	Sherbimet e regjistrimit dhe sigurimeve	145,290	158,800	158,800	184,000	194,000
9	Mirembajtja	580,234	604,500	604,500	443,000	395,500
10	Shpenzimet e marketingut	1,000	1,000	1,000	2,000	2,000
11	Shpenzimet e perfaqesimit	17,000	6,000	6,000	5,900	6,000
12	Llogaritë e Avanseve-P/Cash	3,000	3,000	3,000	3,000	3,000
13	Shpenzimet e komunalive	112,370	112,370	112,370	113,000	114,000
	Gjithsej Shpenzime	6,317,007	6,052,412	6,269,114	6,324,902	6,351,890
	Te Ardhurat - Shpenzimet	927,153	590,757	573,128	555,466	101,252
1	Amortizimi	807,902	527,457	527,457	527,457	83,472
2	Kostoja e Kapitalit	119,251	63,301	45,671	28,009	17,780
	Fitimi/Humbja Neto	0	0	0		

Shënim: Mund të konkludojmë se sipas periudhës shpenzimet gjithsesi do të rriten së paku 10% deri në 15%.



ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 28 nga 45

9. ANALIZA E PLANIT FINANCIAR

Të hyrat

Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-250 për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA), të hyrat e ASHNA-së do të përbëhen nga:

1. Tarifat e shfrytëzuesve të vlerësuara dhe të mbledhura nga ASHNA; dhe
2. Donacionet, grantet dhe çdo mbështetje tjetër financiare ose teknike e dedikuar për ASHNA.
3. Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës, të hyrat e dedikuara të Agjencive të pavarura.
4. Të gjitha të hyrat e dedikuara duhet të depozitohen nga agjencitë e pavarura në Fondin e Kosovës dhe regjistrohen në SIMFK në pajtim me Rregullat Financiare të Thesarit. Të gjitha agjencitë e pavarura duhet të dorëzojnë planin e rrjedhës së parasë së gatshme në Thesar.
5. Të gjitha të hyrat e dedikuara ndahen për secilën agjenci të pavarur sipas Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi. Buxheti i Republikës së Kosovës përfshin të gjitha të hyrat e dedikuara ashtu si pranohen gjatë qdo vitit fiskal.
6. Tërë bilanci i pashpenzuar i të hyrave të dedikuara nga viti paraprak fiskal ndahet dhe autorizohet për vitin fiskal pasues për agjencitë e pavarura sipas Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi, me kusht që shuma maksimale e të Hyrave të Dedikuara e cila ndahet përmes këtij ligji nuk duhet të tejkalojë shumën e specifikuar në tabelat buxhetore të këtij ligji dhe pjesa e mbetur më nuk mund të konsiderohet si e Hyrë e Dedikuar.
7. Shuma e të hyrave të dedikuara të ndara në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni nuk duhet të kalojë ndarjen maksimale për agjencitë e pavarura të specifikuar në ligjin e buxhetit.
8. Nëse gjatë vitit fiskal nuk ka mjete të mjaftueshme të mbledhura dhe në dispozicion, sipas paragrafëve 2 dhe 3 të këtij neni, për të plotësuar kërkesat e përcaktuara në planin e rrjedhës së parasë së gatshme të dorëzuar në Thesar-Ministria e Financave, fondet e tjera publike nga Fondi i Kosovës autorizohen në këtë mënyrë për tu ndarë në një shumë të mjaftueshme për të plotësuar deficitin. Gjatë tërë kohës, të hyrat e dedikuara duhet të përdoren si burim financimi me prioritet të parë për pagesat e Shpenzimeve të Agjencisë së pavarur para se të ndahen dhe përdoren burimet tjera të financimit. Ministri, së paku dy herë në vit, gjatë rishikimit buxhetor dhe në Raportin Financiar, i raporton Komisionit për Buxhet dhe Financa nëse fondet kanë qenë të mjaftueshme dhe cilat masa janë marrë që fondet e duhura të jenë në dispozicion.
9. Përderisa pranohen dhe ndahen të hyrat e dedikuara për vitin fiskal buxhetor ato do të zëvendësojnë të tërë ndarjet dhe financimet e bëra sipas paragrafit 5 të këtij neni në atë nivel që financimi i deficitit nga Fondi i Kosovës të mos jetë shpenzuar ende.
10. Pavarësisht nga paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni, Agjencia për Shërbimet e Navigacionit Ajror në pajtim me Ligjin Nr.04/L-250 për Agjencinë për Shërbimet e Navigacionit Ajror do të financohet tërësisht nga të hyrat e dedikuara dhe të depozituara në Fondin e Kosovës sipas tabelave me këtë ligj(buxhetit). Fondet e mbetura nga të hyrat e dedikuara e të pashpenzuara nga viti paraprak vazhdojnë të trajtohen si të hyra të dedikuara për financim të Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror, për vitet vijuese.
11. Të gjitha mjetet e pashfrytëzuara deri më 31 Dhjetor të çdo vitit fiskal Agjencia për Shërbimet e Navigacionit Ajror nga llogaria e tanishme i bartë në Fondin e Kosovës, në llogarinë zyrtare të hapur nga Thesari, Ministria e Financave për këtë Agjenci.



ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 29 nga 45

Në këtë plan të biznesit jemi bazuar në të hyrat e kufizuara të cilat sigurohen vetëm nga tarifa e aterimit (Approach Fee) dhe një përqindje të vogël të të hyrave tjera të cilat parashikohet të mbulojnë vetëm shpenzimet më esenciale operative. Për pjesën të cilën nuk mund ta mbulojmë nga të hyrat tona do të drejtohem tek institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës pasi siç dihet mirëfilli asnjë Ofrues i Shërbimeve të Navigimit Ajror në rajon apo edhe më gjerë nuk mund ti mbuloj shpenzimet vetëm nga tarifa e aterimit por ato mbulohen nga hapësira e lartë ajrore e cila për një periudhe kalimtare i është deleguar për menaxhim shtetit të Hungarisë apo më saktësisht HungaroControl-it nga NATO. Poashtu edhe për projektet e paraqitura kapitale jemi bazuar në përkrahjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës të zotuar me aprovimin e ligjit të Agjencisë së Shërbimeve të Navigimit Ajror.

Shpenzimet

Në këtë plan pesë vjeçar të biznesit kemi paraqitur shpenzimet e projektuara pas marrjes së "inputeve" nga të gjitha njësitë organizatibe në ASHNA-se për vitin 2024 dhe vlerësimet 2025 -2029.

Gjatë përpilimit të këtij plani vjetor jemi mbështetur në dy parime bazë:

Vazhdimi i ofrimit të shërbimeve të navigimit ajror në hapësirën e ulët ajrore të Republikës së Kosovës; Zhvillimi i infrastrukturës ajrore për të përmbushur nevojat e ardhme operative (në rast të sigurimit të hyrave shtesë)

Shpenzimet e propozuara në këtë plan përfaqësojnë minimumin të shpenzimeve për ofrimin e shërbimeve të navigimit ajror në hapësirën e ulët të Republikës së Kosovës, ku më poshtë do të shpalosim të gjitha shpenzimet.

Tabela me shënime shpjeguese kategoria Paga dhe mëditje

Nr.	Përshkrimi	Buxheti 2024	Kërkesa 2025	Vlerësimet 2026	Vlerësimet 2027	Vlerësimet 2028	Vlerësimet 2029
1	PAGAT DHE SHTESA	3,208,232	3,734,637	3,940,042	4,156,744	4,177,527	4,198,415

Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjnor

Viti	Numri total i stafit	Numri total i stafit që janë gra	Numri total i stafit që janë burra	Paga dhe mëditje/Shuma për gra	Paga dhe mëditje/Shuma për burra
2022	164	29	135	€ 407,119.47	€ 2,504,185.68
2023	162	28	134	€ 449,599.55	€ 2,705,267.77
2024	159	28	131	€ 448,370.64	€ 2,759,859.36
Planifikimi për 2025	192	/	/	/	/
Planifikimi për 2026	193	/	/	/	/
Planifikimi për 2027	194	/	/	/	/
Planifikimi për 2028	195	/	/	/	/
Planifikimi për 2029	196	/	/	/	/



ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 30 nga 45

Tabela me shënime shpjeguese kategoria Mallra dhe Shërbime

Nr	Kufijtë Buxhetor 2025	Kërkesa 2025	Vlerësimet 2026	Vlerësimet 2027	Vlerësimet 2028	Vlerësimet 2029
1	2,470,000	2,470,000	2,000,000.00	2,000,000.00	2,034,375.00	2,039,475.00

Përshkrimi	Buxheti 2024	Kërkesa 2025	Vlerësimet 2026	Vlerësimet 2027	Vlerësimet 2028	Vlerësimet 2029
MALLRAT DHE SHËRBIMET	2,016,257	2,470,000	2,000,000	2,000,000	2,034,375	2,039,475
Shpenzimet e udhëtimit	370,000	350,000	280,000	280,000	275,000	280,000
Shërbimet e telekomunikimit	35,500	58,000	58,000	58,000	56,130	57,130
Shpenzimet për shërbimet	907,756	1,180,476	752,476	812,476	979,845	1,007,845
Blerja e mobiljeve dhe pajisj. Me më pak 1000 euro	8,000	45,000	65,000	5,000	13,000	13,000
Blerjet tjera të mallrave dhe shërbimeve	36,600	61,000	39,224	39,224	35,000	37,000
Derivatet dhe lëndët djegëse	37,500	29,000	32,000	32,000	37,500	44,000
Avanc per para te imet	3,000	3,000	3,000	3,000	3,000	3,000
Shërbimet e regjistrimit dhe sigurimeve	168,000	145,290	158,800	158,800	184,000	194,000
Mirëmbajtja	441,900	580,234	604,500	604,500	443,000	395,500
Shpenzimet e marketingut	2,001	1,000	1,000	1,000	2,000	2,000
Shpenzimet e përfaqësimit-reprezentacionit	6,000	17,000	6,000	6,000	5,900	6,000

Planifikimi në këtë kategori është bazuar në kërkesat e njëjësive shpenzuese-departamenteve të ASHNA-së të cilat kanë priorizuar kërkesat dhe nevojat e tyre për arritjen e objektivave sipas planeve vjetore të punës në organizatën buxhetore.

Shpenzimet e udhëtimit

Shpenzimet e planifikuara dhe të kërkuara për udhëtime zyrtare për vitin dhe 2025-2027 për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror janë kryesisht shpenzime jashtë vendit, për stafin operativ si: Trajnimi i 18 Kontrollorëve për menaxhimin e Hapësirës së Lartë Ajrore, trajnim i cili zgjatë tre muaj. Njëkohësisht është paraparë edhe shkollimi i 24 Studentëve kontrollorë të rinjë, shkollim i cili realizohet jashtë vendit dhe zgjatë gjashtë muaj.

Shërbimet e telekomunikimit

Shpenzimet për shërbime të telekomunikimit janë të bazuara në faturat e shpenzuara nga vitet e mëparshme, në urdhëresën e Qeverisë dhe në Rregulloren e ASHNA-së për shpenzimet e telefonit, shpenzimet për internetin, shpenzimet postare. Shpenzimi më i lartë është për linjat e dedikuara për komunikim dhe sinjale të pajisjeve të navigimit.



ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Arovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 31 nga 45

Shpenzimet për shërbimet

Shpenzimet më të larta janë planifikuar për shërbimet arsimore - trajnuese, ku marrin shumën kryesore të kësaj kategorie ekonomike në të cilën janë trajnimet e rregullta dhe të domosdoshme për mbajtje të licencave dhe kompetecës së Kontrollorve të Trafikut Ajror dhe stafit tjetër operativ dhe njëkohësisht pagesa për shkollimin e Studentëve Kontrollorëve të Trafikut Ajror. Shpenzimet tjera janë kryesisht rutinë dhe të kontraktuara, të domosdoshme për ofrim të shërbimit të navigimit

Blerja e mobiljeve dhe pajisjeve me më pak se 1000 Euro

Në këtë kategori janë të planifikuara pajisje për zyrë dhe kamera të sigurisë.

Blerjet tjera të mallrave dhe shërbimeve

Në këtë linjë janë të paraqitura shpenzimet për furnizim me materiale shpenzuese për zyrë, hixhienë dhe veshëmbathje për stafin operativ në terren.

Derivatet dhe lëndët djegëse

Në këtë kategori janë të përfshira të gjitha shpenzimet që janë të lidhura me derivatet e naftës për vetura dhe r gjeneratorë

Shërbimet e regjistrimit dhe sigurimeve

Në mjetet e planifikuara për këtë kategori janë të përfshira shpenzimet e kontraktuara me tenderim për sigurimin e operimeve të ASHNA-së, që kërkohet nga AACK për ofrim të shërbimeve, sigurimin e aseteve të ASHNA-se si dhe sigurimi dhe regjistrimi i automjeteve në shfrytëzim nga ASHNA.

Mirëmbajtja

Mirëmbajtje e sistemit VHF dhe UHF:

Sistemi i radiokomunikimit UHF dhe VHF, për vitin 2025 nuk parashihet të këtë buxhet operacional edhe, pasi që aktualisht ne veq kemi komisionuar sistemin e ri të radiokomunikimit në Golesh dhe ASHNA, projekt në kuader të projektit të zgjatjes së pistes.

Vitet në vijim do lidhen marrëveshje (SLA) me prodhuesin, gjë që garanton mirëmbajtjen dhe vazhdimësinë e operacionalitetit të sistemit, duke kryer mirëmbajtje të nivelit të tretë, e cila është zhvillohet vetëm nga prodhuesi i sistemit/pajisjes..

Mirëmbajtje e sistemit VCSS

Aktualisht posedojmë dy sisteme:

VCS Garex -i cili është instaluar në vitin 2015 dhe tanimë përdoret si "Backup" dhe

VCS SITTl, i cili është instaluar në vitin 2022 dhe përdoret si sistem primar. Ky sistemka garancion deri në vitin 2024

Në periudhën vijuese ASHNA vazhdon me marrëveshjet (SLA) me prodhuesin për sistemet në fjalë.



ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 32 nga 45

Mirëmbajtja AWOS/ATIS/VOLMET, SLA:

Në kuadër të projektit Zgjatja e pistës, nga kompania DTN është bërë instalimi i sistemeve AWOS/ATIS dhe VOLMET. Gjatë vitit 2025 do të lidhet marrëveshja (SLA) me prodhuesin-instaluesin e sistemeve.

Në periudhën vijuese ASHNA vazhdon me marrëveshjet SLA me prodhuesin për sistemet në fjalë.

Mirëmbajtje e sistemit për parashikim të motit

Në kuadër të projektit të zgjatjes së pistës është instaluar sistemi për parashikim të motit, i cili është komisionuar dhe futur në operim.

Prandaj në vitin 2024 kemi lidhur kontratë për SLA. Validiteti i kontratës është një vit dhe përfundon në Gusht të vitit 2025. Në periudhën vijuese ASHNA vazhdon me marrëveshjet SLA me prodhuesin për sistemin në fjalë.

Licencimi i frekuencave nga ARKEP:

Komunikimi zanor në mes të kontrollorëve të trafikut ajror dhe pilotëve, realizohet me sisteme të radiokomunikimit në frekuenca të caktuara aeronautike. Këto frekuenca aeronautike ndahen nga organizatat e aviacionit si ICAO, EUROCONTROL, kurse në nivel të Republikës së Kosovës, këtë përgjegjësi e ka Autoriteti i Komunikimeve elektronike dhe postare –ARKEP. ASHNA ka planifikuar ripërtërirjen e Licensës së frekuencave për periudhën e këtij Plani Biznesi 2025 – 2029.

Linja e dedikuar optike ASHNA- Golesh, Germi, Gjakovë (Shërbim):

Gjatë vitit 2024 është finalizuar lokacioni i radiokomunikimit në Gërmë. Për t'ju qasur këtij lokacioni me sistemin e VCS, përpos komunikimit me antena mikrovalore është realizuar edhe një linjë e dedikuar nga lokacioni i Gërmisë deri tek ASHNA nga Telekomit i Kosovës. Ndërsa duhet të realizohet edhe një linjë shtesë.

Si rikapitullim, për linjat e dedikuara për vitin 2025 planifikohet vendosja/instalimi:

Linja optike Golesh–ASHNA (një linje Optike);

Linja optike Gjakovë – ASHNA (dy linja të dedikuara);

Linja optike Gërmë–ASHNA (dy linja të dedikuara);

Linja e dedikuar me MNAV- Maqedoni e Veriut;

Linja e dedikuar me ALBCONTROL- Shqipëri.

Licenca vjetore EUMETSAT (Shërbim):

Sistemi për parashikimin e motit merr të dhëna meteorologjike nga Agjencia Evropiane e Satelitëve Meteorologjik - EUMETSAT. ASHNA ka nënshkruar kontratë për këto shërbime meteorologjike me Agjencinë Evropiane – Eumetsat. Në periudhën e këtij plani ASHNA do të mbajë licensën dhe ripërtërijë atë në marrëveshje kontraktuale të vazhdueshme, meqë imazhet satelitore meteorologjike janë të domosdoshme për ofrimin e shërbimeve meteorologjike.



ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 33 nga 45

Sistemi i AFTN-së-Rutinimi i mesazheve Aeronautike:

Sistemi i AFTN daton qysh nga viti 2010. Përmes sistemit të AFTN-se bëhet procesimi i mesazheve aeronautike si planet e fluturimeve dhe mesazhet e asocuara me planin përkatës,, si dhe dërgimi i mesazheve meteorologjike METAR dhe TAF.

Sistemi i AFTN-së-Mirëmbajtje

Në mënyrë që të ofrojm një shërbim efikas në lidhje me mirëmbajtjen e sistemit AFTN , për vitin 2023 kemi paraparë një buxhet për mirëmbajtjen e sistemit të AFTN-së.

Mirëmbajtje e linjës ASHNA- (Golesh, Germi, Gjakove) (Riparime eventuale):

Shumica e komunikimeve optike dhe pajisjeve të tyre përcjellëse që janë pronë e ASHNA-së kerkojnë një buxhet mirembajtje në rast të defekteve eventuale si në pjesën passive të rrjetes, poashtu edhe ne ate aktive. Kontrata për këtë shërbim është lidhur dhe ka validitet 1 vjeçar dhe skadon në vitin 2025. Duhet të vazhdohet SLA që të sigurohet kontinuiteti i mirëmbajtjes ndër vite.

Kalibrimi nga Ajri i Sistemeve të Navigimit:

Ky shërbim është i obligueshëm bazuar në Rregulloren e AAC-së Nr.03/2011.

Meqenëse Kalibrimi bëhet në baza të rregullta përmes shërbimeve të kontraktuara me kontratë 3 vjeçare.

Kontrata për kalibrimin e sistemeve nga ajri, skadon në vitin 2025 dhe do vazhdohet sipas procedurave të aplikueshme.

Mirëmbajtja e Sistemeve të Navigimit

Përcjellja e kontratës së lidhur për SLA me prodhuesin e ILS-ve INTELKAN. Kontrata ka validitet 1 vjeçar dhe skadon në fund të vitit 2025, planifikohet ripërtëritje e kontratës me afat tre vjeçar.

Sistemet e Navigimit qe ne i mirëmbajmë janë:

- ILS (Sisteme e aterimit instrumental) 17
- ILS (Sisteme e aterimit instrumental) 35
- DVOR/DME.

Riparim i Sistemeve të Navigimit:

Pavarësisht pjesëve rezervë me të cilat planifikojmë të furnizohemi në të ardhmen, Sistemet e Navigimit mund të pësojnë edhe defekte të cilat kërkojnë riparim i cili bëhet jashtë vendit. Planifikime pas vitit 2025.

Kalibrimi i pajisjeve testuese:

Të gjitha instrumentet të cilat përdoren për mirëmbajtjen e Sistemeve të Navigimit duhet të kalibrohen në baza të rregullta, siç e parasheh prodhuesi i tyre. Në 7 vitin 2024 jemi furnizuar me një "Signal



ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 34 nga 45

Generator” me të cilin plotësohen kërkesat momentale për kalibrim të pajisjeve testuese. Planifikim pas vitit 2027.

Pjesë rezervë për mirëmbajtjen e përgjithshme të Sistemit të Survejimit:

Për ofrimin e shërbimeve radarike, ASHNA përdorë dy sisteme të survejimit radarik: Radarin sekondar MSSR Mode S, që është i instaluar në lokacionin e Goleshi dhe poashtu Radarin MSSR Mode S/I që është i instaluar në lokacionin e Aeroportit të Gjakovës. Pjesët rezervë janë esenciale për mirëmbajtjen e sistemit radarik.

Një nga pjesët esenciale të radarit MSSR Mode S/I është “rotary joint”, e cila do të prokurohet në fazën e parë të implementimit të projektit të azhurimit të radarit për vitin 2025.

Pjesët rezervë për mirëmbajtjen e përgjithshme të Sistemit të Navigimit:

Për vitet në vijim, në projektin pjesë rezervë për sistemet e navigimit të cilat janë paraparë bazuar në listat e pjesëve rezervë për sistemet e navigimit që nevojitet për sigurimin e vazhdimësisë së ofrimit të shërbimeve në rast të defekteve, e cila listë është kërkesë obligative e AACK.

Mirëmbajtja e sistemeve të Survejimit, SLA:

Mirëmbajtja e duhur dhe e rregullt e sistemeve radarike, është esenciale si për shkak të rëndësisë së sistemit, edhe për kompleksitetin dhe gjendjen teknike të sistemit. Për këtë arsye nevojitet arritja e një marrëveshje me prodhuesin (SLA) në mënyrë që të mund të garantojmë punë të mirë dhe të rregullt të sistemit të survejimit. Jemi në proces të Upgrade të Radarit të Goleshit pas të cilit vijon garancioni dy vjeçar, prandaj duhet të planifikohet SLA për radarin e Gjakovës për vitin 2026.

Pajisje me kamera të sigurisë dhe mirëmbajtja e tyre:

Me zgjerimin e hapësirave të ASHNA është rritur nevoja edhe për zgjerimin e mbulueshmërisë me kamera të sigurisë, që nënkupton furnizim me kamera shtesë për këtë qëllim.

Sistemi i kamerave i instaluar në ASHNA kërkon mirëmbajtje vjetore të pajisjeve.

Strukturimi i kabllimit & pjesë rezervë:

Në këtë projekt parashihet të furnizohemi me pjesë reserve për serverat ekzistues të ASHNA për të divizionin e TI-së dhe divizionet tjera të Departamentit Teknik

Mirëmbajtja dhe servisi i gjeneratorëve:

Mirëmbajtja dhe servisi i gjeneratorëve bëhet në intervale të caktuara kohore, të specifikuara nga prodhuesi (1 herë në vit) ose sipas orëve të punës. Aktualisht ASHNA posedon 18 gjeneratorë.

Mirëmbajtja dhe servisi i UPS-ve:

Mirëmbajtja e servisi i UPS-ve bëhet në intervale të paracaktuara kohore të specifikuara nga prodhuesi.

Me projektin Zgjatja e Pistës, në fund të vitit 2022 janë instaluar sisteme të reja të navigimit ajror, ku si pajisje përcjellëse bëjnë pjesë edhe 8 (tetë) UPS të rinjë.



ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 35 nga 45

Përmes të njëjtin projekt janë funksionalizuar edhe sistemet e reja meteorologjike , me ç'rast është shtuar edhe numri i UPS-ve. Aktualisht ASHNA posedon 16 UPS.

Mirëmbajtja dhe servisimi i klimatizimit në lokacione operative

Mirëmbajtja dhe servisimi i klimatizimit bëhet në intervale të paracaktuara kohore të specifikuara nga prodhuesi. Aktualisht ASHNA posedon 30 klima të këtij lloji.

Mirëmbajtje e sistemeve të ZTLK (Riparime eventuale):

Mirëmbajtja e sistemeve të rrymë dhe dhe tension të lartë, jo çdo herë mund të parashikohen prishjet eventuale të sistemeve të cilët janë të shumtë në numër, prandaj me anë të këtij parashikimi planifikohet të bëhen riparimet në klimatizim.

Të Tjera (Mirëmbajtja):

Në këto linja janë të përfshira edhe shpenzimet e mirëmbajtjes së automjeteve operative dhe administrative të ASHNA-së për 14 njësitë organizative si dhe marrëveshjet e mirëmbajtjes - SLA (Service Level Agreement) të cilat janë marrëveshje me kompanitë prodhuese për mirëmbajtje profesionale të të gjitha pajisjeve të cilat shërbejnë për ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror.

Shpenzimet e marketingut

Planifikimi i shpenzimeve të marketingut është i bazuar në kërkesat dhe nevojat e njërive organizative për vitin 2024-2026, si dhe në masën e mjeteve të realizuara në tremujorin e parë të vitit 2023

Në këtë kategori të shpenzimeve bëjnë pjesë: konkurset e ndryshme për nevoja të ASHNA-së, botimet e broshurave, udhëzuesve dhe informatorëve të ndryshëm..

Shpenzimet e Përfaqësimit-Reprezentacionit

Shpenzimet e përfaqësimit janë të bazuara në Udhëzimin Administrativ të Qeverisë që përcakton lartësinë dhe personat që kanë të drejtë shfrytëzimi.

Kategoria - Shpenzimet e Komunalive

Nr	Përshkrimi	Buxheti 2024	Vlerësimet 2025	Vlerësimet 2026	Vlerësimet 2027	Vlerësimet 2028	Vlerësimet 2029
1	SHPENZIMET E KOMUNALIVE	162,370	112,370	112,370	112,370	113,000	114,000

Agjencia për Shërbimet e Navigacionit Ajror llogaritjen e kategorisë së shpenzimeve komunale e ka bazuar në faturat e furnizimit për shpenzimet e bëra ndër vite si dhe në pjesën e parë të vitit 2024.



ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 36 nga 45

Kategoria Kapitale e shpenzimeve kapitale

Nr.	Pasuria	Burimi i financimit	Kufijt 2025	Vleresimi 2026	Vleresimi 2027	Vleresimi 2028	Vleresimi 2029
1	Sistemi i Ri i Procesimit të dhenave ATM	GQ	1,893,942	1,127,561			
2	Furnizim me automjete	GQ	179,999	100,000	280,000		
3	Pajisje për Linjat e dedikuara me shtetet fqinje Voice +Data	GQ	268,608				
	Pajisje për Linjat e dedikuara me shtetet fqinje Voice +Data	THD	31,392				
4	AMHS – System- Automatic Message Handling System	THD	600,000				
5	Rregullimi dhe renovimi i hapësirave të punës në ASHNA	THD	28,608		650,000		
6	Projekti i Energjise së Ripertrishme	GQ	460,000		400,000	500,000.00	450,000
7	Ndertimi i katit të dytë të objektit të ASHNA-së	THD	300,000	1,100,000			
8	Upgrade i Radarit Golesh	GQ	180,001				
9	Furnizimi me UPS industrial	THD	80,000		120,000	150,000	
10	Blerja e mobileve dhe inventarit	THD	10,000	104,989	200,000	50,000	100,000
11	DME-DME (Distance Measuring Equipment)	THD		600,000	732,550		
12	Multilateration (MLAT)	GQ		600,000	1,000,000	400,000	
13	Pajisje të teknologjise informative	GQ		100,000	350,000		200,000
14	UTM - Unmanned Aircraft System traffic Management	GQ				800,000	1,200,000
TOTAL:			4,032,550	3,732,550	3,732,550	1,900,000	1,950,000

Burimi i Financimit:

THD - Te hyra të dedikuara		1,050,000
GQ - Grante qeveritare		2,982,550

Sistemi për Menaxhimin e Trafikut Ajror - ATM:

Sistemi për Menaxhimin e Trafikut Ajror-ATM, është sistem i domosdoshëm për menaxhim të trafikut ajror në hapësirën e ulët dhe lartë ajrore të Kosovës.

Sistemi aktual është relativisht i vjetëruar dhe përveç kufizimeve operative, ka vështirësi edhe në mirëmbajtjen e tij.

Në linjë me misionin e ASHNA-së dhe objektivat e saj, që lidhen edhe me Planet Strategjike Kombëtare të Zhvillimit (ofrimi i shërbimeve në hapësirën e lartë ajrore), ASHNA është në proces të instalimit të sistemit të ri ATM, përmes projektit "Supply, installation and operation of the Air Traffic Management System" 254-23-3743-2-1-1/C175.

Projekti si i tillë ka filluar në vitin 2023 dhe realizohet sipas afatave dhe kriterëve të përcaktuara në kontratë dhe si tërësi i ka katër shtylla:

Shtylla 1: Furnizimi, instalimi dhe operimi i sistemit për menaxhimin e trafikut ajror,



ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 37 nga 45

Shtylla 2: Furnizimi dhe instalimi i konsolova operuese,
Shtylla 3: Trajnimi i personelit për ACS (kontrollimi i trafikut ajror ne hapësirën e lartë ajrore),
Shtylla 4: Dizajni dhe rikonstruksioni i dhomes te kontrollit të trafikut ajror për shërbimet e ACC dhe APP.

Projekti pritet të përfundoj në vitin 2026. Gjatë viteve 2025 dhe 2026 do vazhdohet me furnizimin, instalimin e sistemit në njësi operuese, si dhe të përfundohet trajnimi për ASC.

Furnizim me automjete

2025- Flota ekzistuese e automjeteve të ASHNA-s është vjetruar, duke krijuar kosto të larta mirëmbajtjeje dhe duke ulur sigurinë e përdorimit të tyre, prandaj është thelbësore zëvendësimi me automjete të reja. Ky zëvendësim do të ulë shpenzimet operacionale dhe do të përmirësojë sigurinë në transportin e personelit dhe pajisjeve të ndjeshme teknike.

Pavarësisht se në vitin 2024 janë pranuar tre (3) automjete të reja dhe tre të tjera janë kontraktuar për vitin 2025, nevoja për zëvendësimin e automjeteve të mbetura të vjetra mbetet esenciale për të përmirësuar shërbimet. Automjetet e reja të planifikuara për këtë projekt synojnë të mbulojnë të gjitha pikat e operacioneve, si Goleshin, Gërmin dhe Gjakovën, duke rritur efikasitetin e lëvizjes dhe gatishmërinë e personelit në të gjitha kushtet.

Në Projektin e energjisë së ripërtitshme, planifikohet që të instalohen edhe 3 stacione të mbushjes elektrike, që nënkupton se automjete elektrike do të planifikohen dhe blihen në vitet në vijim.

Pajisje per Linjat e dedikuara me shtetet fqinje Voice+Data:

Linjat e dedikuara janë linja specifike të komunikimit mes njërive fqinje të trafikut ajror. Aktualisht ASHNA ka të vendosura linja te dedikuara me MNAV dhe ALBONTROL, përmes linjes së HUNGAROCNTROL-it.

Për të krijuar lidhje direkte me njësitë fqinje, planifikohet implementimi i një sistemi, i cili mundëson ndër lidhjen e sistemeve tona të komunikimit menjësitë fqinje..

Perveç linjës zanore të komunikimit, ne te ardhmën e afërt do të shkëmbejmë edhe sisteme të planeve të fluturimeve, FDP dhe figurën (imazhet e radarit).

Ky sistem parashihet të jetë redundant dhe të ketë të integruar Firewall të kohës, i cili na mbron nga sulmet e jashtme kibernetike.

AMHS – System- Automatic Message Handling System:

ASHNA për dërgimin dhe pranimin e mesazheve të koduara të planeve të fluturimeve dhe atyre meteorologjike përdorë sistemin aktual të AFTN-it. Kjo formë e dërgimit dhe pranimit të mesazheve në shumë shtete veq është e tejkaluar, sepse kanë kaluar në platforma tjera konform rregullave dhe standardeve të fundit të ICAO dhe Eurocontrol.

Standardet e ICAO dhe ato të Eurocontrol obligojnë shtetet anëtare që të kalojnë-migrojnë në sisteme më të avancuara të dërgimit dhe pranimit të ketyre mesazheve (informatave aeronautike), nga AFTN në AHMS.



ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 38 nga 45

Në shumë shtete anëtare kjo nismë veq ka filluar qysh nga 2010, ku janë implementuar sistemet e para të AMHS dhe më pastaj edhe linqet në mes shteteve anëtare në formë të AMHS.

Shtetet që akoma nuk kanë migruar në sistemet AMHS apo akoma kanë sistemin e AFTN-it, janë obliguar të implementojnë "Gateway" (konverter Hardwerik dhe softwerik), në menyrë që mesazhet e pranuar në formatin AMHS t'i konverton në formatin e mesazhit të AFTN-së dhe anasjelltas.

Tanimë shumë shtete të botes kanë implementuar sistemet e dergimit të mesazheve aeronautike në formatin AMHS, sepse sistemet në formatin e mesazheve të AFTN veq janë duke u larguar nga përdorimi. Kjo ndodh për arsye të përmbushjeve të obligimeve të dala nga organizatat nderkometare për avijacion (ICAO Eurocontrol), dhe formati i mesazheve të AMHS janë më të avancuara si për nga formati i mesazhit, po ashtu edhe për nga siguria e tyre.

Edhe neve si ANSP duhet të jemi në pajtim me keto norma apo standarde, që vijn nga organizatat botërore të avijacionit –ICAO dhe Eurocontrol.

Ne akoma përdorim sistemin AFTN, në form të dergimit të mesazheve aeronautike, por që të jemi konform standardeve të ICAO-s dhe Eurocontrol, duhet patjetër që në ardhmen e afërt të bëjmë përgaditjet për migrimin nga sistemi i AFTN në AMHS.

Me implementimin e këtij projekti ne si ANSP, do të jemi konform rregullave dhe obligimeve që kërkojnë organizatat botërore të avijacionit, si dhe do të ngritet në nivel të caktuar kualiteti i shërbimit si dhe siguria e informative aeronautike. Poashtu mesazhet nga shtetet anëtare do të i marrim direkt si mesazhe AMHS, e jo si mesazhe të konvertuara nga "Gateway" të ndryshëm nga AFTN në AMHS

Migrimi sipas ICAO Doc 9880 (Part II, section 3.4) i ka dy nivele

- "Basic ATSMHS"-Niveli bazik dhe
- Extended ATSMHS-Niveli I Zgjeruar

Ne si ASHNA do të përcaktohem për nivelin e zgjeruar të implementimit. Shpresojmë që në të ardhmen e afërt të implementohet ky projekt dhe më këtë të plotësohen standardet e kohës, konform obligimeve dhe standardeve të avijacionit sipas ICAO dhe Eurocontrol.

Rregullimi dhe renovimi i hapësirave të punës në ASHNA

ASHNA ka shtuar kapacitetet në dhënien e shërbimeve dhe si rrjedhojë disa hapësira brenda objekteve të ASHNA-së, të koncentruara në pjesën operative nevojitet të rregullohen dhe renovohen me qëllim të sigurimit të kushteve më të mira për punë. Me realizimin e projektit kapital ATM, shumë zyra në ASHNA janë marr në shfrytëzim për ndërtimin e Sallës operative të Radarit, ku ka rezultuar me rritjen e detyrueshme për renovimin e disa hapësirave të brendshme për akomodim të nevojave sipas standardeve ndërkombëtare nga fusha e avijacionit të cilat na obligojnë që departamenteve të Operimeve të iu sigurohen kushte të mira për punë, konform nivelit të përgjegjësisë së tyre profesionale. Njëkohësisht ne këto renovime është planifikuar të realizohet edhe zgjerimi i brendshëm i Kullës si dhe depoz qendrore të ASHNA-së.



ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 39 nga 45

Projekti i energjisë së ripërtëritshme:

Ky projekt tanimë është në fazën e ankesave ne OSHP, dhe mund të mos realizohet gjatë vitit 2024 dhe buxheti i këtij viti është planifikuar për vitin 2025 andaj edhe është rritë vlera e kërkesës për vitin 2025 nga 100,000 në 460,000.

Nga raportet e përmbledhura vjetore mbi konsumin dhe shpenzimet e energjisë elektrike të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror, si dhe nga parashikimet për vitet në vijim, kuptojmë për ngritje të konsumit të energjisë elektrike, rrjedhimisht edhe të shpenzimeve.

Konsiderojmë se është e dobishme dhe momenti i duhur për të filluar dhe zbatuar një plan për konsum racional të energjisë në ASHNA.

Ky projekt, përveç tjerash përkon edhe me objektivat e Republikës së Kosovës në eficiencën e energjisë, burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Nga observimet dhe komunikimet e zhvilluara me ekspert të kësaj fushe, kemi kuptuar se një projekt i tillë, nënkupton insatimin e sistemeve përkatëse dhe të avancuara, që do instaloheshin në premiset e ASHNA-së dhe të cilat me kohë do mundësonin shfrytëzimin e plotë të energjisë së ripërtëritshme për nevojat e ASHNA-së.

Ndërtimi i katit të dytë të objektit të ASHNA-së:

ASHNA, aktualisht është në ambiente/zyre të punës në objektin e ndërtuar me kontratën PPP, nga Limak Kosova ANP "Adem Jashari", në një sipërfaqe rreth 2000 m², hapësirë kjo jo e mjaftueshme për akomodimin e nevojave të ASHNA-së. ASHNA, ka të aprovuar numër të punëtorëve prej 160 nëpunësve, ku me investimet e fundit në pajisje të navigimit ajror, është paraqitë nevoja për rritjen e hapësirave për pajisjet dhe për hapësirat operative, që ka rezultuar me zvogëlimin edhe më tej të kapaciteteve të hapësirave të punës. Mbi këtë bazë është planifikuar që gjatë vitit 2025, të nisë ndërtimi i katit të dytë të objektit ekzistues në ASHNA, më një sipërfaqe prej 1700 m², i cili parashihet që të akomodoj nevojat e ASHNA-së për hapësirat e punës. Ky projekt pritet të përfundojë në vitin 2026.

Azhurnimi (Upgrade) i Radarit në Golesh:

Ky projekt është në fazën e implementimit dhe sipas planifikimit dinamik të kryerjes së punimeve është vlerësuar se nga planifikimi i buxhetit prej 1.2 milion euro për realizim për këtë vit, do të realizohen punë deri në vlerën e 1.02 milion eurove, ndërsa është planifikuar që për vitin 2025 të planifikohet edhe vlera e mbetur për realizim të këtij projekt prej 180 mijë eurove.

Riparimi gjeneral-përmirësimi (upgrade) e sistemit të radarit Mode S, është i nevojshëm për ASHNA-në, pasi që siguron operimin afatgjatë të këtij radari. Sistemi i survejimit radarik sekondar MSSR Mode S është instaluar në Golesh dhe është operativ nga muaji maj 2013. MSSR Mode S përdoret për të siguruar detektimin e fluturakeve në hapësirën e ulët ajrore të Republikës së Kosovës. Të dhënat e radarit sekondar MSSR Mode S të instaluar në Golesh poashtu shfrytëzohen edhe për distribuimin e të dhënave radarike nga Hungaro-Control për qëllime të kontrollit të hapsirës së lartë ajrore dhe mundëson në të ardhmen që këto të dhëna radarike të distribuohen edhe me shtetet fqinje me interes të përbashkët për të ngritur kualitetin dhe sigurinë e trafikut ajror. Nga koha e instalimit të MSSR Mode S në vitin 2013, kemi hasur në shumë probleme në vazhdimësi, probleme të cilat janë paraqitur edhe nga Rrregullatori



ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 40 nga 45

AAC gjatë proceseve të auditimit të sigurisë, me kërkesën obligative që këto probleme duhet të eliminohen për rritje të sigurisë së operimeve.

Me riparimin gjeneral-permirësimin e sistemit radarik, nga sistemi aktual MSSR Mode S kalon në gjeneratën e fundit Mode S/I, ku radarit aktual do t'i rritet funksionaliteti, jetëgjatësija për një periudhë minimum dhjetë vjeçare si dhe garancion dy vjeçarë të funksionimit të plotë të sistemit radarik.

Furnizimi me UPS industrial:

Sistemet e UPS-ve të instaluar në objektin e ASHNA-së janë UPS-ë industrial që sigurojnë furnizim të pandërprerë me energji eektrike të të gjitha pajisjeve në pozitat operative të ASHNA-së, gjegjësisht Dhomat e Serverevë, pozitave operative në Kullë, APP, DMET, DAIS si dhe dhomën e monitorimit në DTEK. Rëndësia e funksionalitetit të tyre është jetike për operime të vazhdueshme dhe pa ndërprerje.

Objekti i ASHNA-së ka dy sisteme të ndara të UPS-ve (2x60KVA) industrial njëri furnizon Dhomën e serverëve (pajisjeve), ndërsa tjetri furnizon pozitata e lartcekura operative. Konfigurimi i tyre është bërë në atë mënyrë që të minimizohet dështimi në vazhdimsinë e furnizimit me energji elektrike dhe ate duke instaluar dy UPS (2x60KVA) paralel në të dy sistemet.

Sistemet e UPS-ve janë mirëmbajtur në vazhdimsi dhe janë në gjendje optimale operacionale.

Me projektin e sistemit të ri të ATM i cili është në fazën e implementimit janë paraparë pajisje të reja të cilat do të shtojnë në masë të konsiderueshme shpenzimet energjetike. Nga kalkulimet e siguruara nga OE që do të bëj instalimin e sistemit të ri të ATM-it përfshirë edhe shpenzimet aktuale tejkalojnë kapacitetin e UPS-ve aktual. Shpenzimet e kalkuluara janë për njërin sistem të UPS-ve 54.40 KVA, respektivisht 52.48 KVA për tjetrin.

Propozimi i OE sipas kalkulimeve është që UPS-ët 2 x 60KVA të zëvendësohen me 2 x 120 KVA për njërin sistem, ndërsa për sistemin tjetër zhvendosja dhe integrimi i njërit UPS 60 KVA nga sistemi i pare, kjo gjithnjë duke u bazuar që shpenzimet nuk duhet të tejkalojnë 80% të kapacitetit të UPS-ve. Sipas kontratës aktuale me OE për sistemin e ri të ATM-it ASHNA është përgjegjëse për pjesën e furnizimit energjetik.

Blerja e mobileve dhe inventarit

Nevoja për sigurimin e një ambienti të përshtatshëm për punë, ka të bëjë me plotësimin e standardeve ndërkombëtare nga fusha e aviacionit civil, të cilat na obligojnë që Kontrollorëve të trafikut ajror dhe departamenteve tjera operative e administrative të iu sigurohen kushte të mira për punë, konform nivelit të përgjegjësisë së tyre profesionale.

Standardi i cilësisë së lartë të inventarit (karrigeve të punës, dhe enterierit të brendshëm) është i nevojshem si pasojë e punës me sres dhe presion që kanë departamentet operative dhe gjithashtu edhe puna gjatë 24 orëve, kërkon kushte për të mundur që zyrtarët të jenë të koncentruar në punë dhe shërbimi të kryhet pa problem. Gjatë 24 orëve stafi jep shërbim, duhet të ushqehet dhe pushoj në vendin e punës dhe ASHNA ka obligim përmbushjen e këtyre kërkesave.



ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 41 nga 45

DME-DME (Distance Measuring Equipment):

DME-DME (Distance Measuring Equipment) në aviacion përcakton distancën në mes fluturakes dhe pozicionimin e saktë në tokë. Është sistem i cili është i pavarur nga GPS të cilët janë të bazuar në të dhënat satelitore, përkatësisht është sistem i navigimit që përdoret në aviacion për të matur distancën e drejtë mes aeroplanit dhe një pike të bazuar në tokë. Navigimi DME-DME bazohet në dy pajisje DME që punojnë së bashku për të përcaktuar pozicionin e aeroplanit në lidhje me pikat e bazuar në tokë, duke ofruar informacion të saktë për distancën në kohë reale.

Aktualisht ASHNA këtë sistem e ka të bazuar në GPS me bazë satelitore, dhe me këtë sistem synohet që të krijohet matje e pavarur mes fluturakes dhe distancës së aeroportit apo distancës me pika të caktuara në tokë.

Multilateration – (MLAT)

Për të kontrolluar trafikun ajror në hapsirën ajrore të Republikës së Kosovës, ASHNA ka të instaluar dy sisteme radarike, MSSR Mode S në Golesh dhe një MSSR Mode S/I në Aeroportin e Gjakovës. Këto sisteme të survejimit shfrytëzojnë dy radio-frekuenca për transmetim dhe pranim të sinjalit radarik, të cilat janë të aprovuara nga organizatat ndërkombëtare të aviacionit civil ICAO dhe Eurocontrol.

Me sistemet ekzistuese të survejimit mundësohet përcjellja e fluturakeve në hapsirën ajrore të Kosovës, prej momentit kur hyjnë në hapsirën e Kosovës, deri sa të atërojnë dhe anasjelltas. Duke pasur parasysh nevojat operative që do të kemi në të ardhmen, siq janë hapja e hapsirës së lartë mbi Republikën e Kosovës dhe hapja e korridoreve të reja ajrore me shtetet fqinje, si dhe përcjellja e fluturakeve nga momenti i aterimit e deri te parkimi i tyre, paraqitet nevoja e një aranzhimi të ri të hapsirës së kontrolluar të Republikës së Kosovës. Argument shtesë është edhe projekti i realizuar i zgjatjes së pistës dhe instalimi i sistemeve përcjellëse të vrojtimit dhe sistemeve të aterimit instrumental të fluturakave.

Ky aranzhim nënkupton hapjen e zonave të reja të fluturimeve në nivele të caktuara. Me këtë rast, përpos shërbimeve APP dhe TWR (që edhe ato janë të ndara në disa zona) do të ofrohet edhe shërbimi ACC (Area Control Center) dhe kontrollimi i fluturakeve por edhe makinave të tjera që hyjnë dhe dalin në hapësirën manovruese.

Duke shfrytëzuar të dhënat e survejimit, kontrollori i trafikut ajror vrojton dhe udhëzon fluturaket në zona të caktuara gjatë rrugëtimit në hapsirën ajrore në përgjegjësin e tij. Hapja e zonave të reja, rrugëve të reja ajrore dhe shtimi gjithnjë e më i madh i trafikut ajror, duke pasur këtu parasysh edhe kriteret strikte për siguri në aviacion nga ICAO dhe Eurocontrol, implikon domosdoshmërin për paisje më të sofistikuar të Sistemit RADAR-ik.

Gjithashtu, kemi pasur në mendje edhe nevojën operative, që secila zonë e kontrolluar e hapësirës ajrore të Kosovës, të ketë mbulueshmëri të trefishtë. Nevoja për mbulueshmëri të trefishtë, për shkaqe të pranim dorëzimit të aeroplanëve, paraqitet në zonen prej tridhjetë miljave nautike përreth hapësirës ajrore të Republikës së Kosovës.

Megjithëse Sistemi RADAR-ik aktual si sistem i survejimit është shumë stabil, megjithatë koha e përdorimit të tij është bazuar në pjesë rrotulluese mekanike të cilave iu duhet mirëmbajtje në intervale kohore shkak i amortizimit të këtyre pjesëve lëvizëse. Duke e patur parasysh këtë fakt, e kemi parë të nevojshme që në një të ardhme të mendohet për t'u pajisur me sensor të ri të survejimit (MLAT, ADS-B)



ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 42 nga 45

i cili sistem do ta plotësonte (njëherë), e më vonë plotësisht të zëvendësonte këtë sistem. Me këtë sistem mundësohet përcjellja e fluturakeve në hapsirën manovruese por edhe ne zonat e kontrolluara ajrore, në varshmëri nga numri i senzoreve. Poashtu, mundësohet fleksibilitet më i madh i mbulueshmerisë, meqenëse numri i senzoreve mund te rritet në varshmëri nga zonat që janë me interes për të'u kontrolluar. Sistemi i tillë MLAT mundëson edhe shfrytëzimin e të dhënave ADS-B, pasi që është i integruar në këtë sistem.

Pajisje të Teknologjisë Informative:

Gjatë vitit 2026 planifikohet që të rregullohet furnizimi me internet sekondar, duke u siguruar menaxhimi i tij më i sigurtë dhe një nëndarje e rrjetave aktuale. Kjo do arrihet përmes prokurimit/furnimizmit të paisjeve specifike.

Gjithashtu është e nevojshme edhe funksionalizimi i linjes "Dark Fiber" me aeroportin e Gjakovës duke u furnizuar me pajisje amplifikatore dhe SFP, që e mundësojnë komunikimin në distanca të largëta siq është aeroporti i Gjakoves. Paisjet aktuale të rrjetit janë vjetëruar dhe disa nga ato janë jashtë përdorimit për shkak të jofunksionalitetit (3 switcha) dhe është e nevojshme furnizimi me paisje përkatëse për këtë qëllim.



ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 43 nga 45

10. RREZIQET DHE NDIKIMI NË PLANIN E BIZNESIT

Në përpilim e këtij plani, sigurisht që kemi marrë në konsideratë dhe rreziqet potenciale, të cilat i trajtojmë përmes Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë dhe me procesin e Menaxhimit të Riskut. Në vijim do paraqesim një përmbledhje të rreziqeve.

- **Rreziqet e jashtme** - janë rreziqet që reflektojnë rrethanat jashtë organizatës;
- **Rreziqet ligjore** - janë rreziqet që reflektojnë rrethanat ligjore të organizatës;
- **Rreziqet financiare** - janë rreziqet që lidhen me disponueshmërinë e burimeve të nevojshme;
- **Rreziqet për burimet njerëzore** - janë rreziqe operative që shoqërohen në mënyrë specifike me çështjet e personelit;
- **Rreziqet operative** - janë rreziqet e punës që do të mund të ndikonin zhvillimin e veprimtarisë

Përmes Manualit për Menaxhimin e Riskut, përkatësisht Rexhisitrit të Rreziqeve, ASHNA identifikon, klasifikon dhe menaxhon ne vazhdimësi rreziqet potenciale në organizatë.




ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 44 nga 45

11. SKEMA ORGANIZATIVE E ASHNA





ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Titulli: PL-ASHNA-B25-29
Data e Aprovimit: 29-11-2024
Versioni: 1.0
Klasifikimi: I brendshëm
Faqe: 45 nga 45

12. AZHURNIMI I PLANIT AFATGJATË TË BIZNESIT

Ky plan afatgjatë i biznesit azhurnohet bazuar në ndryshimet që afektojnë edhe planin vjetor të biznesit dhe domosdoshmërisht azhurnohet në baza vjetore.

z. Samir Bllacaku

Drejtore

